

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË IUVENIS SHPK

THEMELIMI

NENI 1 - ORTAKËT THEMELUES

1.1 Shoqëria IUVENIS SHPK themelohet nga Ortakët:

Z. Ingrid Shyti, shtetas shqiptar, lindur më 19-05-1987, banues në Tiranë, mbajtës i Nr. Personal I70519111I, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

Z. Aldo Dervishi, shtetas shqiptar, lindur më 03-03-1985, banues në Tiranë, mbajtës i Nr. Personal I50303056E, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

Znj. Ledia Dervishi, shtetase shqiptare, lindur më 24-01-1989, banuese në Tiranë, mbajtëse e Nr. Personal I95124051J, madhere dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

Z. Erjon Profnasta, shtetas shqiptar, lindur më 14-08-1985, banues në Tiranë, mbajtës i Nr. Personal I508140825, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

të cilët me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë krijojnë shoqerinë si vijon.

EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

NENI 2 – EMËRTIMI

2.1 Emërtimi i shoqërisë është “**IUVENIS**” SHPK (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

NENI 3 - FORMA LIGJORE

3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjeter në përputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 4 - BAZA LIGJORE

4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Akt Themelimi dhe Statut, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore ne fuqi.

4.2 Për sa nuk është parashikuar ne ketë Statut, do te aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

4.3 Çdo mosmarrëveshje që mund të lind në lidhje me zbatimin dhe/ose interpretimin e këtij Statuti, do te zgjidhet nga gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.



NENI 5 - PERSONALITETI JURIDIK. KOHËZGJATJA

- 5.1 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në Tiranë, Shqipëri.
- 5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pakufizuar.

NENI 6 - SELIA

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Njësia Bashkiake nr.1, Bulevardi "Bajram Curri", pallati N.C.E., apartamenti 3/8, Tiranë.
- 6.2 Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.
- 6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera Shqiptare ose te huaja që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

NENI 7 - EMBLEMA. VULA

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemët dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.
- 7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjisacionit shqiptar.
- 7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemën dhe vulën e saj.

NENI 8 - OBJEKTI

- 8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do te jetë:
Import - eksport të produkteve të ndryshme industriale.
- 8.2 Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër i cili është ne përputhje me Ligjet e Republikës se Shqipërisë.

NENI 9 – KAPITALI THEMELTAR

- 9.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 Lekë (lekë).
- 9.2 Kapitali themeltar përbahet nga 4 (katër) kuota.
- 9.3 Pjesët e kapitalit themeltar zotërohen nga ortakët në masën si më poshtë:
Z. Ingrid Shyti zotëron 1 (një) kuotë me vlerë nominale 50,000 (pesëdhjetë mijë) Lekë që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
Z. Aldo Dervishi zotëron 1 (një) kuotë me vlerë nominale 20,000 (njëzet mijë) Lekë që përbën 20% të kapitalit themeltar të shoqërisë.



Znj. Ledia Dervishi zotëron 1 (një) kuotë me vlerë nominale 20,000 (njëzet mijë) Lekë që përbën 20% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Z. Erjon Profnasta zotëron 1 (një) kuotë me vlerë nominale 10,000 (dhjetë mijë) Lekë që përbën 10% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

9.4 Kapitali është shlyer tërësisht.

9.5 Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

NENI 10 - TRANSFERIMI I KUOTAVE. KUFIZIMET

10.1 Kuota e kapitalit është e transferueshme dhe mund të transferohet në çdo moment sipas kushteve dhe afateve të parashikuara nga ligji shqiptar.

10.2 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi pjesët e kapitalit në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Asamblesë së Ortakëve.

ORGANET E SHOQËRISË

NENI 11 - VENDIMET E ASAMBLESË SË ORTAKËVE

11.1 Asambleja e Ortakëve në përputhje me legjislacionin shqiptar, mund të vendosë, por pa u kufizuar në to, vendimet me poshtë:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre nga administratori ose administratoret, përfshi raportet financiare;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- miratimin e shkrirjes/bashkimit me shoqëri te tjera;
- ndryshimin e statutit të shoqërisë;
- ndryshimin e selisë dhe të emërtimit të shoqërisë;
- emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se është e nevojshme;
- rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar palëve të treta;
- ristrukturimin dhe prishjen shoqërisë;
- emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë;
- miratimin e pasqyrave financiare të shoqërisë dhe raportit te administratorit(eve);
- vendimin për shpërndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve
- transformimin e shoqërisë në formë të tjera;
- dhe çdo lëndë tjetër të parashikuar nga statuti ose nga ligji.

NENI 12 - ADMINISTRIMI

12.1 Administrimi i shoqërisë do te kryhet nga një ose më shume administratorë që emërohen me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Në rast se Shoqëria do të administrohet nga më shumë se një administrator, atëherë Administratorët mund t'i ushtrojnë kompetencat bashkërisht ose veçmas sikurse do të përcaktohet në vendimin përkateë të Asamblesë së Ortakëve.

12.2 Administratori i parë i shoqërisë është:

Z. Ingrid Shyti, shtetas shqiptar, lindur më 19-05-1987, banues në Tiranë, mbajtës i Nr. Personal I70519111.



- 12.3 Administratoreve u jepen te gjitha kompetencat e përcaktuara nga legjislacioni i Republikës se Shqipërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar ne to, Administratoret janë përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:
- drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
 - përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
 - hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
 - përgatitjen e dokumenteve në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zotëron;
 - të lidhë kontrata për dhe në emër të shoqërisë me palë të treta, të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjeter që konsiderohet i nevojshëm për mbarëvajtjen e aktivitetit të shoqërisë;
 - të përfaqësojë shoqërinë përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankës së Shqipërisë si dhe të kryej çdo transaksion bankar në emër të shoqërisë;
 - të ndërmarrë çdo veprimtari tjeter, ose biznes, ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshëm për administrimin efikas te Shoqërisë në Shqipëri.
- 12.4 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për pesë vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- 12.5 Administratori i Shoqërisë mund t'i transferojë çdo personi apo grupei personash te gjitha apo një pjese te kompetencave te tij sipas këtij Statuti dhe me kushtet qe ai konsideron si të arsyeshme dhe në çdo kohë mund të anullojë këtë transferim kompetencash.

NENI 13 - VITI FINANCIAR

- 13.1 Viti finanziar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.
- 13.2 Përashtimisht, viti i parë finanziar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

NENI 14 - BILANCI. KONTABILITETI.

- 14.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatumore dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit deri në fund të muajit Mars to cdo viti pasardhës.
- 14.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhen dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkësave te legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vittit.
- 14.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 15 - TE ARDHURAT, DIVIDENDI

- 15.1 Shoqëria mund të krijojë fonde rezerve për realizimin e qëllimeve të aktivitetit të saj në përpunhje me kërkësat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

- 15.2 Fitimet që do të rezultojnë në fund të mbylljes së çdo viti ushtrimor, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahen nga Asambleja e Ortakëve.
- 15.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo ortak do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

NENI 16 – LIKUIDIMI

- 16.1 Likuidimi e Shoqërisë si dhe emërimi i likuidatorit(ëve) behet ne përputhje me ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe çdo ligj tjeter te zbatueshëm.

NENI 17 – MOSMARRËVESHJET

- 17.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

NENI 18 - KLAUZOLË MBYLLËSE

- 18.1 Ky Statut hartohet në 3 (tre) ekzemplare me fuqi të njëjtë ligjore.

ORTAKET

Z. Ingrid Shyti




Znj. Ledia Dervishi



Z. Aldo Dervishi



Z. Erjon Profnasta



Date 22/01/2020